

Thirrje për dorëzimin e eseve

Misioni i OSBE-së në Shkup shpallë konkurs për dorëzimin e eseve mbi “Rolin e OSBE-së në botën e sotme”, si pjesë e një sërë aktiviteteve për shënimin e 40 vjetorit të Aktit të Helsinkit.

Në vitin 2015, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) do të shënojë 40 vjetorin nga nënshkrimi i Aktit Final të Helsinkit. Ky përvjetor paraqet një mundësi unike për të riafirmuar përkushtimin e Shteteve pjesëmarrëse për konceptin e sigurisë gjithëpërfshirëse, bashkëpunuese, të barabartë dhe të pandashëm, si dhe për të përmbushur sfidat e shekullit njëzet e një.

Si të aplikoni:

- Të gjithë studentët e interesuar të ciklit universitar dhe pasuniversitar (të regjistruar në një nga universitetet në vend) janë të ftuar të paraqesin propozimet për ese
- Studentët e interesuar duhet të dërgojnë propozimin në gjuhën angleze (maksimum 300 fjalë) në e-mail adresën: mihajlo.lahtov@osce.org, jo më vonë se më 20 shkurt 2015
- Propozimet e përzgjedhura do të ftohen të dorëzojnë ese të plota (në gjuhën angleze, maqedonase, ose shqipe), të cilat do të vlerësohen nga një komision i brendshëm (maksimum 3000 fjalë)
- Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të ftohen për vizitë studimore në Misionin e OSBE-së në Shkup

Tri esetë më të mira do të fitojnë udhëtim studimor në Vjenë për të vizituar selinë kryesore të OSBE-së

Temat e mundshme:

- Roli i OSBE-së si organizata më e madhe e sigurisë rajonale në botë dhe evoluimi i saj në të ardhmen
- Angazhimet e Dimensionit njerëzor të OSBE-së në fushën e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, si dhe rëndësia e tyre në vend
- Roli i Misionit të OSBE-së në vend dhe kontributi i saj në zgjidhjen e sfidave nga fusha të ndryshme (për shembull: arsim, marrëdhënie ndëretnike, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, policia, etj.)

Propozime për tema tjera lidhur me punën e OSBE-së janë gjithashtu të mirëpritura.

Kontakt personi:

Mihajlo Lahtov
Telefoni: +389 2 323 4615
Mobil: +389 70 358 920
E-mail: mihajlo.lahtov@osce.org
Webfaqja: www.osce.org/skopje/